

ASAMBLESE SE ORATKEVE TE SHOQERISE

“BAD” sh.p.k

TIRANE

RAPORT MBI ZMADHIMIN E KAPITALIT TE SHOQERISE.

1. Me perfshirjen e fitimeve dhe rezervave

1. OBJEKTI I MISIONIT.

Me vendim te dates 28.06.07, te Asamblese se Ortakeve te shoqerise “BAD” sh.p.k Tirane, me eshte drejtuar mua si Eksperte Kontabel e Autorizuar, me nr 6 date 10.02.2000, te licenses, per te paraqitur nje raport mbi zmadhimin e kapitalit te shoqerise.

Une si Eksperte Kontabel e Autorizuar, e pranova misionin e percaktuar ne vendimine Asamblese se Ortakeve, duke patur parasyshe kerkesat e nenit 168,169 te ligjit nr 7638 date 19.11.1992, “Per shoqerite Tregtare”, mbi papajtueshmerite mbi emerimin e Ekspertit kontabel te autorizuar.

Per te kryer kete misione, nga ana e shoqerise me eshte vene ne dispozicion , pasqyrat financiare te ushtrimit 2006, si dhe te gjitha dokumentat e tjera qe e bene te besueshem kete raport.

Ne cilesine time si Eksperte Kontabel e Autorizuar dhe ne zbatim te misionit te parashikuara nga ligjet, vendimet dhe dokumentacionin jane si me poshte:

1. Ligji nr 7638 date 19.11.1992, “Per shoqerite tregtare” kreu IV.
2. Ne ligjin nr 7661 date 14.01.1993, “Per kontabilitetin”.
3. Ligjin nr 8438 date 28.12.1998, “Per Tatimin mbi te ardhurat” neni 33/1.
4. Vendimet e asamblese se ortakeve , mbi te cilen emerohet eksperti kontabel, per te realizuar misionin e zmadhimit te kapitalit.
5. Vendimin e Gjykates Rrethit Tirane nr 27014 date 21.01.2002, per regjistrimin ne regjistrin tregtare te shoqerise “BAD” sh.p.k Tiarne si person juridik
6. Bilancet dhe anekset plotesuese qe pasqyron veprimtarin ekonomike dhe financiare per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2006

Po ju paraqesim raportin tone mbi zmadhimin e kapitalit

2. PERIUDHA E REFERIMIT

Vleresimi i gjendjes pasurore dhe financiare të shoqërisë është bërë sipas llogarive vjetore (bilanci dhe anekset plotësuese) për periudhën deri më 31.12.2006, të miratuar nga ortakët.

3. TE DHENAT E PERGJITHSHME

Shoqëria "BAD" sh.p.k është krijuar si shoqëri me përgjegjësi kufizuese me vendim të Gjykatës Rrethit Tiranë me nr 27014, datë , që është e depozituar në regjistrin tregtarë me kapital fillestarë në shumën prej 100.000 leke , gjatë ushtrimeve kanë bërë rritje kapitali në shumën prej 19.400.000 leke e ndarë në pjesë 19.400 pjesë, me ortakë

1. ADRIATIK XURRE 50% të pjesëve të kapitalit ,në vlerën prej 9.700.000 Leke ndarë në 9.700 pjesë.

2. BAJRAM HOXHALLARI 50% të pjesëve të kapitalit ,në vlerën prej 9.700.000 leke e ndarë në 9.700 pjesë

OPINIONE PËR VLERESIMIN E AKTIVIT.

Nga verifikimet e kryera nga ana ime në dokumentacionin kontabel të shoqërisë rezultojnë se aktivet e shoqërisë sipas bilancit të mbyllur më datë 31.12.2005, përbehen si më poshtë:

Bilanci i ushtrimit 2006, rezultojnë si më poshtë:

	AKTIVI	VLERA		PASIVI	VLERA
			A	KAPITALET E VETA	54.801.065
A	AQT	13.810.180	1	Kapitali i nënshkruar	19.400.000
B	AQ	89.914.682	2	Rezerva ligjore	73.445
			3	Rezervat statutores	
			4	Fitimet e mbartura	35.327.620
			5	Provizionet	
				DETYRIMET	48.923.797
	TOTALI	103.724.862		TOTALI	103.724.862

AKTIVET E QENDRUESHME përbehen nga :

A. Aktivet e qëndrueshme të trupezuara:

- Ndertesa në shumën prej - leke
- Makineri dhe pajisje në shumën prej 18.514.856 leke,
- Mjetet transporti në shumën prej 4.400.471 - lek

Te gjitha aktivet,jane te vleresuar me koston historike, jane perfshire ne bilanc , jane ne pronesi te shoqerise dhe te vertetuara me dokumetin e hyrjes.

B. Aktivet Qarkulluese perbehen nga:

- Gjendje inventari dhe ne proces 83.216.036 leke
- Kerkesa per arketim debitoresh 1.314.751 leke
- Likujditete dhe vlera arka te tjera 5.383.895 leke

TOTALI 89.914.682 leke

Aktivete jane reale, ekzistojne, jane te vleresuar sipas rregullave e parimet kontabel dhe I perkasin shoqerise.

OPINIONE PER VLERESIMIN E PASIVIT.

Nga verifikimet e kryera nga ana ime ne dokumentacionin kontabel te shoqerise rezulton se pasivet e shoqerise sipas bilancit te mbyllur me date 31.12.2006, perbehen si me poshte:

- 1.Kapitalet e veta te shoqerise 54.801.065 leke
- 2.Detyrimet 48.923.797 leke
- TOTALI 103.724.862 leke**

Nga verifikimet e kryera ne dekuwentacionin kontabel te shoqerise shpreh opinionin tim pa rezerva se te gjitha detyrimet jane te regjistruara ne kontabilitet ne baze te dokumentave jane vleresuar ne baze te parimeve dhe rregullave kontabel I perkasin shoqerise dhe jane deklaruar ne pasqyrat financiare te rregullta, kete opinion e kame shprehur edhe kur kam bere certifikimin e llogarive vjetore te ushtrimit 2005.

A. Kapitalet e veta te shoqerise

Sipas bilancit kontabel te veprimtarise te mbyllur me date 31.12.2006, kapitalet e veta rezultojne ne shumen prej 54.801.065 leke ,te cilat jane te barabarta me Totalin e aktivitet 103.724.862 leke- Detyrimet 48.923.797 leke = 54.801.065 leke, dhe perbehen :

- 1. Kapitali themeltare 19.400.000 leke
- 2. Rezerva ligjore 73.445 leke
- 3. Fitimi I mbartur leke
- 4. Fitimi I vitit ushtrimor 35.327.620 leke
- TOTALI 54.801.065 leke**

Ne mbledhjen e Asamblese e zakonshme te ortakeve per ndryshimin e statutit,eshte marre ne shqyrtim destinimi I fitimeve,e pasqyruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, dhe eshte vendosur qe fitimi I ushtrimit ,2006 , ne shumen prej 33.800.000 leke te kalohet ne shtese kapitali, duke bere zmadhimin e kapitali, dhe ne shumen prej 1.600.000 leke do ta kaloje ne rezerve ligjore e statutore.

REZERVAT QE PERFSHIHEN NE SHTESE (ZMADHIMIN) E KAPITALIN THEMELTARE jane si me poshte:

Te gjitha rezervat, perfshire edhe ate te domosdoshme (ligjore), mund ti bashkohet kapitalit themeltare, madje edhe primet apo fitimet e ushtrimeve mund te kapitalizohen, keto do ti bashkohen kapitalit themeltare pasi ne bilancet kontable te shoqerise nuk ka humbje te mbartura.

Rezervat jane si me poshte:

1	Rezerva ligjore	72.380 leke
2	Rezerva statutore	
3	Fitime te mbartura deri 2005	leke
4	Fitimi I ushtrimit 2006	33.727.620 leke
5	totali	33.800.000 leke

Mbase zmadhimit te kapitalit themeltare bilanci I shqerise I mbyllur me date 31.12.06 merr formen si me poshte:

	AKTIVI	VLERA		PASIVI	VLERA
				KAPITALET E VETA	54.801.065
A	AQT	13.810.180	1	Kapitali I nenshkruar	53.200.000
B	AQ	89.914.682	2	Rezerva ligjore	1.602.130
			3	Fitim i ushtrimit	
			4	Provigjonet	
			5	Detyrimet	48.923.797
	TOTALI			TOTALI	
		103.724.862			103.724.862

Pra sic rezulton edhe nga bilancet , zmadhimi I kapitalit me perfshirjen e fitimeve nuk ndryshone madhesia e aktivit neto apo kapitalet e veta te shoqerise.

Kapitalet e veta mbase zmadhimit te kapitalit, rezultojne ne shumen prej 54.801.065 leke ,te cilat jane te barabarta me Totalin e aktivit 103.724.862 leke- Detyrimet 48.923.797 leke = 54.801.065 leke.

Ndarja e kuotave , mbase zmadhimit te kapitalit rezulton:

**1. ADRIATIK XURRE 50% te pjeseve te kapitalit ,ne vleren prej
26.600.000 Leke ndare ne 26.600 pjese.**

**2. BAJRAM HOXHALLARI 50% te pjeseve te kapitalit ,ne vleren prej
26.600.000 leke e ndare ne 26.600 pjese**

KONTABILIZIMI

DEBI			KREDI		
1	Rezerva ligjore	72.380	1	Kapitali I nenshkruar	33.800.000
2	Fitimi ushtrimi,2006,	33.727.620			
3	Kompesim kredie				
4	rezerva				
TOTAL		33.800.000		TOTALI	33.800.000

**Kapitali Fillestare
Shtese kapitali nga fitimet 2006
TOTALI**

**19.400.000 leke
33.800.000 leke
53.200.000 leke**

KONKLUZION

Si rezultat I verifikimeve te bera dhe duke patur parasyshe edhe hollesite e dhena me sipërne cmojme qe vlera neto kontabel e elementeve qe perbejne aktivin e shoqerise dhe kapitalet e shoqerise, ashtu sic dalin edhe nga pasqyrat financiare qe I jane aneksuar ketij raporti jane ne pajtueshmeri me rregullat dhe parimet kontable dhe perbejne nje vleresim normal dhe te arsyeshem.

Dhe si perfundim te operacionit te zmadhimit te kapitalit, mendoje se misioni im mbi kete operacion ka perfunduar , ky vleresim I paraqitet per miratim Asamblese se Ortakeve

EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR

TIRANE me 28.06.07

/ Ajeta SHKEMBI /

**Eksperite Kontabile Autorizuar
AJETA SHKEMBI
Nr. 115.6
ALBANIA**